



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 723/1 Prot.

Tiranë, më 23/02/2026

VENDIM SENATI

Nr. 5 Datë 23/02/2026

**“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË NDRYSHIMEVE NË PAGAT E PUNONJËSVE
MBËSHTETËS NË UBT-ë SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 87,
datë 06.02.2026”**

Në përputhje Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026 “Për buxhetin e vitit 2025”, si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 87, datë 06.02.2026 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, ‘Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike’, të ndryshuar” si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 723 Prot., datë 20.02.2026, në mbledhjen e tij të datës 23.02.2026, Senati Akademik:

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim ndryshimet e shtesës mbi pagën bazë mujore për klasë për punonjësit mbështetës në UBT-ë, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 87, datë 06.02.2026.
2. Të miratojë në parim shtesën mbi pagën bazë mujore për klasë për punonjësit mbështetës në UBT-ë, sipas lidhjes nr. 2 të VKM- së nr. 87, datë 06.02.2026.
3. Ky vendim së bashku me relacionin e përgatitur nga DFE dhe DBNJSHJ të përcillen për miratim në mbledhjen më të afërt të Bordit të Administrimit të UBT-së.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU

